Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 68-të, të mbajtur më datë 20.05.2022 morri,

VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-1300/1 datë 22.02.2020, e krijuar me vetiniciativë , në përputhje me Planin Vjetor të monitorimit të gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2020, për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënave nga fleta anketuese, _____, kryetar i Gjykatës së Shkallës së Parë _____ NDËRPRITET.

Nuk ka elemente për veprime të mëtejshme kompetente të KSHPK-së në lëndën me numër 08-1300/1 të datës 22 shkurt 2020.

Lënda me numër 08-1300/1të datës 22.02.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-1300 / 1 të datës 22.02.2020 u formua me vetiniciativë, në përputhje me Planin Vjetor për monitorimin e gjendjes pronësore dhe interesave për vitin 2020.

KSHPK, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, për pronën e---------- dhe anëtarëve të familjes së tij morri të dhëna nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e të Hyrave Publike, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK, duke vepruar sipas lëndës, nga procesverbalet e veta konstatoi se _____, në afatin e përcaktuar me ligj pas përfundimit të detyrës, Kryetar i Gjykatës Themelore _____, nuk ka dorëzuar fletë anketuese në K SHPK.

KSHPK në pajtim me nenin 114 paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtje, zbatoi procedurë të shlyerjes gjatë së cilës është lëshuar urdhërpagesë për kundërvajtje me numër 08-1300/14 të datës 22.12. .2020, e cila në pajtim me Ligjin për Kundërvajtje, i është dorëzuar në mënyrë të rregullt kryerësit dhe kryerësi nuk ka vepruar në afatin e caktuar.

KSHPK, Komisionit për Kundërvajtje në KSHPK, ka paraqitur kërkesë për fillim të procedurës për kundërvajtje ndaj të emëruarve me numër 08-3379/1 të datës 13.09.2021.

Komisioni për Kundërvajtje në KSHPK me Vendim me nr. 14-1281/5 të datës 10.11.2021 e shpalli përgjegjës për kundërvajtje personin e emëruar nga neni 82 paragrafi 3 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe shqiptoi sanksion për kundërvajtje - GJOBË në shumë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit.

KSHPK, pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet kompetente si dhe vendimit të miratuar të Komisionit për Kundërvajtje, konstaton se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në rastin konkret.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti:
Miratoi:

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Nuri Bajrami